



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 17 janar 2012
Nr. ref.: RK 183/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 10/11

Parashtrues

Nexhat Ramadani

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan
P.Nr.142/04, të 19 majit 2005 dhe aktgjytimeve të Gjykatës Supreme,
Ap.Kz.Nr.179/2007, të 23 qershorit 2009 dhe
Nr PKL-KZZ 131/09, të 5 qershorit 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Nexhat Ramadani, nga Gjilani, momentalisht në vuajtje të dënimit me burgim në Dubravë.

Baza juridike

2. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Vendimi i kontestuar

3. Në kërkesën e vet parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan P.Nr.142/04, të datës 19 maj 2005. Ai po ashtu përmend dhe dorëzon kopjet e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Ap.Kz.Nr179/2007, të datës 23 qershor 2009 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Nr. PKL-KZZ 131/09, të datës 5 qershor 2010, që iu dorëzua avokatit të tij mbrojtës më 5 gusht 2010.

Procedura në Gjykatë

4. Më 5 dhjetor 2010, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi letër Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata) duke pretenduar shkeljet e të drejtave individuale të njeriut.
5. Më 27 janar 2011, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) bashkë me dokumentacionin e nevojshëm.
6. Më 14 shkurt 2011, Kryetari emëroi gjyqtaren Snezhana Botusharova për Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Gjyljeta Mushkolaj.
7. Më 15 shkurt 2011, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës lidhur me kërkesën.
8. Më 31 gusht 2011, Gjykata e Qarkut në Gjilan i siguroi Gjykatës kopjen e Aktgjykimit të vet P.Nr.142/04, të datës 19 maj 2005, si dhe aktgjykimet e Gjykatës Supreme Ap.Kz.No179/2007, të datës 23 qershor 2009, dhe Aktgjykimin Nr PKL-KZZ 131/09, të datës 5 qershor 2010.
9. Më 29 nëntor 2011, pas shqyrtimit të raportit paraprak të Gjyqtares raportuese, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës së plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 19 maj 2005, Gjykata e Qarkut në Gjilan me Aktgjykimin e vet të datës 19 maj 2005, dënoi parashtruesin e kërkesës me 16 vjet burgim për vepër penale vrasje e rëndë, sipas neneve 146 dhe 147 pika 5 në lidhje me nenin 25 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (UNMIK/REG/2003/25, në tekstin e mëtejme: KPPK) si dhe për pjesëmarrjen në kryerjen e veprës penale në grup, të paraparë me nenin 200 paragrafi 1 të KPPK-së.
11. Sipas këtij aktgjykimi, parashtruesi i kërkesës u shpall fajtor sepse ndër të tjera, më 17 mars 2004 ai "privoi nga jeta S.P., kur në bashkëpunim me bashkëfajtorët e tjerë duke ndjekur S.P., me rastin e sulmit në pronën e tij nga një turmë e zemëruar, ai kërceu sipër trupit të S.P. duke e qëlluar dy herë me shkop, njëherë në krahë dhe njëherë në kokë, përderisa pjesëtarët e tjerë të turmës sulmuan S.P. me shkopinj dhe gurë."

12. Parashtruesi i kërkesës u ankua në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, duke pohuar shkelje të procedurave esenciale penale, veçanërisht (nenit 403 paragrafi 1 pika 12 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (UNMIK/REG/2003/26, në tekstin e mëtejme: KPPPK), shkelje të Kodit Penal (neni 404 i KPPPK), vlerësim të gabueshëm dhe jo të plotë të situatës faktike (neni 405 KPPPK) dhe dështimit të gjykatës për të përcaktuar dënimin e tij në mënyrë korrekte (neni 406 të KPPPK).
13. Më 23 qershor 2009, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin e vet Ap.Kz Nr 179/2007, aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës lidhur me kundërvajtjen për ndihmë në vrasjen e rëndë. Gjykata Supreme konstatoi se ligji i vjetër (neni 30 paragrafi 2 pika 5 LPK) është ligj i aplikueshëm sepse ligji i ri (nenet 146 dhe 147 pika 5 në lidhje me nenin 25 KPPK) nuk ishte më i favorshëm për të pandehurit. Ky rikualifikim i veprës nuk pati efekt në dënimin i cili mbeti 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet burgim. Pjesa tjetër e ankesës është refuzuar.
14. Më 25 nëntor 2009, që të dy, parashtruesi i kërkesës dhe avokati i tij mbrojtës, paraqitën kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut P. Nr 142/04, të datës 19 maj 2005, dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Ap.Kz.Nr.179/2007, të datës 23 qershor 2009. Mbrojtja e parashtruesit të kërkesës paraqiti kërkesë për shkak të, siç pretendohet, shkeljeve të procedurave esenciale të përkohshme penale (neni 403 par. 1 pika 12 e KPPPK) si dhe shkeljeve të Ligjit Penal (neni 404 i KPPPK) me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut. Po ashtu, mbrojtja e parashtruesit të kërkesës paraqiti edhe kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme për shkeljet e pretenduara të Ligjit Penal të Kosovës. Ishte argumentuar, ndër të tjera se, “Arsyet janë tërësisht të paqarta dhe deri në një masë në kundërshtim me faktet kritike dhe dëshmitë nga dëshmitarët e dëgjuar si dhe dëshmitë e përpunuara në shqyrtimin kryesor dhe përmbajtja e dokumenteve dhe procesverbalit nga këndvështrimi kryesor”. Parashtruesi i kërkesës po ashtu paraqiti kërkesë të bazuar në shkeljen e ligjit penal dhe shkeljeve të Procedurës Penale në dy aktgjykimet e lartpërmendura.
15. Më 15 qershor 2010, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin Nr PKL-KZZ 131/09 dhe refuzoi që të dy kërkesat, atë të parashtruesit të kërkesës dhe të avokatit të tij mbrojtës për mbrojtje të ligjshmërisë, si të pabazuara. Është theksuar, ndër të tjera se, “Gjykata Supreme plotësisht pajtohet me atë çfarë ka theksuar gjykata e shkallës së dytë, çka është në pajtim me standardet ligjore ndërkombëtare dhe Evropiane”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pohon shkeljen e nenit 23 [Dinjiteti i njeriut], nenit 24 [Barazia para ligjit] dhe nenit 31 [E drejta për gjykim të ndershëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ka pasur shkelje të të drejtës së tij për dinjitet njerëzor siç garantohet me nenin 23 të Kushtetutës, nga momenti kur Prokurori Publik në Qarkun e Gjilanit parashtrroi padi kundër tij me dyshimin për vrasjen e S.P., si dhe nëpër të gjitha vendimet e ndryshme gjyqësore sepse ato të gjitha rezultonin me etiketimin e tij si “vrasës, kriminel, shovinist, dhe vrasës mizor”.
18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kishte shkelje të të drejtës së barazisë para ligjit siç garantohet me nenin 24 të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës pohon se ai ishte vendosur

Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Nr. PKL-KZZ 131/09, të datës 5 qershor 2010. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata Kushtetuese nuk vëren se procedurat përkatës ishin në çfarëdo mënyre të padrejta apo arbitrare (shih *mutatis mutandis* Shub kundër Lituaniës, Vendimi GJEDNJ për pranueshmërinë e kërkesës, Nr. 17064/06, i datës 30 qershor 2009).

27. Nga kjo rrjedh se, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhet refuzuar si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, njëzëri:

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Snezhana Botusharova



Prof. Dr. Enver Hasani